



PAKETA E AFTËSIMIT DIGJITAL

MODUL TRAJNIMI





PAKETA E AFTËSIMIT DIGJITAL

MODUL TRAJNIMI

TIRANË 2026

“Ky modul u realizua nga Qendra A.L.T.R.I në kuadër të projektit “*Të Rinjtë Për Vendimmarrjen: Teknologji, Art dhe Pjesëmarrje!*” me mbështetjen financiare të Bashkisë Kamëz.

Përmbajtja

<i>Hyrje</i>	<i>5</i>
➤ <i>Moduli 1: Koncepti i E-demokracisë, platformat ekzistuese dhe avantazhet e përdorimit të tyre</i>	<i>6</i>
➤ <i>Moduli 2: Njohuritë bazë të nevojshme për përdorimin e internetit.....</i>	<i>18</i>
➤ <i>Moduli 3: Prezantimi i platformave ekzistuese dhe shpjegimi mbi mënyrën e përdorimit të tyre</i>	<i>23</i>
➤ <i>Moduli 4: Siguria në përdorimin e internetit dhe platformave. Mbrojtja e të dhënave personale dhe shmangia e keqinformimit.....</i>	<i>33</i>
➤ <i>Moduli 5: Platforma e-demokracia</i>	<i>39</i>
➤ <i>Moduli 6: Ushtrime praktike për përdorimin e platformave</i>	<i>41</i>

HYRJE

Rinia është një nga motorët kryesorë të ndryshimit demokratik dhe shoqëror. Përfshirja e saj aktive në proceset e vendimmarrjes, sidomos përmes mjeteve të demokracisë digjitale, përbën një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një qeverisjeje më transparente, gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj nevojave të qytetarëve. Në këtë kuadër, *projekti i Qendrës ALTRI “Të Rinjtë Për Vendimmarrjen: Teknologji, Art dhe Pjesëmarrje!”*, i mbështetur nga Bashkia Kamëz, synon të fuqizojë të rinjtë me aftësi digjitale që u mundësojnë të kuptojnë, përdorin dhe ndikojnë në proceset e demokracisë vendore në mënyrë efektive.

Angazhimi dhe pjesëmarrja qytetare janë themel i çdo shoqërie demokratike. Me digjitalizimin e shpejtë të jetës publike, pjesëmarrja qytetare po zhvendoset gjithnjë e më shumë në hapësirën virtuale, ku platformat dhe mjetet digjitale ofrojnë mundësi të reja për komunikim, konsultim dhe bashkëvendimmarrje. Këto forma të pjesëmarrjes digjitale kanë rezultuar efektive në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe aksesit në informacion publik, duke u bërë një komponent i domosdoshëm i funksionimit demokratik modern.

Megjithatë, në Shqipëri, përfshirja efektive e të rinjve nëpërmjet mjeteve të demokracisë digjitale mbetet ende e kufizuar. Shumë prej tyre nuk janë të informuar mbi ekzistencën dhe funksionimin e platformave që nxisin pjesëmarrjen qytetare si *Vendime.al*, *Open Data*, *Stop Korrupsioni*, *Pyesni Shtetin*, apo *Përmirësoni Qytetin Tuaj*. Si pasojë, një pjesë e madhe e të rinjve ndihen të përjashtuar nga proceset që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e tyre shoqërore dhe komunitare.

Një tjetër pengesë e rëndësishme është mungesa e aftësive bazë digjitale, veçanërisht te të rinjtë në zonat rurale dhe komunitetet e marginalizuara. Vetëm rreth gjysma e qytetarëve shqiptarë zotërojnë aftësi të tilla, çka krijon një hendek të thellë digjital dhe, rrjedhimisht, përjashton grupe të caktuara nga pjesëmarrja përmes mjeteve elektronike. Kjo situatë është edhe më e ndjeshme për të rinjtë nga komunitetet romë dhe egjiptianë, ata me aftësi të kufizuara ose që përballen me vështirësi ekonomike, të cilët për shkak të barrierave të shumëfishta shpesh mbeten jashtë hapësirës së vendimmarrjes publike.

Në këtë kontekst, fuqizimi i të rinjve përmes aftësimit digjital është një domosdoshmëri për të forcuar qeverisjen vendore dhe për të ndërtuar komunitete më gjithëpërfshirëse dhe të ndërgjegjshme. Ky proces kërkon ndërhyrje të qëndrueshme përmes trajnimeve, aksesit në teknologji, promovimit të historive të suksesit dhe përdorimit të metodologjive krijuese, që e bëjnë pjesëmarrjen më tërheqëse dhe kuptimplotë për rininë.

Në përgjigje të këtyre nevojave, është përgatitur “Paketa e Aftësimit Digjital”, një modul praktik dhe gjithëpërfshirës që synon t’u ofrojë të rinjve njohuritë bazë për aksesin, kërkimin dhe përdorimin e platformave të e-demokracisë, mbrojtjen e të dhënave personale, shmangien e dezinformimit dhe përdorimin efektiv të instrumenteve të pjesëmarrjes qytetare. Kjo paketë synon të bëhet një urë që lidh të rinjtë me institucionet, duke i kthyer ata në aktorë aktivë dhe të barabartë në proceset e vendimmarrjes lokale dhe kombëtare.

➤ **MODULI 1: Koncepti i E-demokracisë, platformat ekzistuese dhe avantazhet e përdorimit të tyre**

Kohëzgjatja: 1.5-2 orë

Metodologjia: Metodologjia e përdorur në këtë modul do të jetë ajo e prezantimit të koncepteve dhe parimeve kryesore të e-demokracisë, të platformave dhe avantazheve të përdorimit të tyre nga qytetarët e kombinuar kjo me pjesëmarrjen aktive të të trajnuarve (metoda e kombinuar të mësimdhënies me pjesëmarrjen aktive të atyre që trajnohen). Paraqitja e materialit do të bëhet përmes prezantimit në power-point (ppt) dhe paraqitjes vizive të ilustrimeve për zëra të ndryshëm që trajtohen në këtë modul.

Objektivat: Ky trajnim synon mundësimin e aftësive digjitale të qytetarëve për të kuptuar dhe përdorur në mënyrë efektive instrumentet e demokracisë digjitale në nivel vendor, duke u fokusuar në njohjen me konceptet bazë mbi e-demokracinë, disa nga platformat digjitale aktuale dhe avantazhet që ato paraqesin. Meqenëse pjesëmarrja elektronike luan një rol thelbësor në shumicën e koncepteve të demokracisë digjitale, është zhvilluar një tipologji e përfshirjes së qytetarëve të bazuar në aksesin në internet (online), duke formësuar kështu disa praktika të pjesëmarrjes elektronike.

Grupi i synuar: Ky modul trajnimi është konceptuar si për individë që kanë nevojë për njohuri bazë në përdorimin dhe aksesin e platformave digjitale, apo që kanë nevojë të asistohen në përdorimin e tyre, ashtu edhe për ata që janë tashmë të familjarizuar me to.

Rezultatet: Moduli do t'i ndihmojë pjesëmarrësit të:

- Njihen me konceptin e e-demokracisë dhe koncepte të tjera që lidhen me të.
- Njihen dhe përdorin aplikacione digjitale, duke u ofruar përfituesve përvojën e duhur të aksesimit të tyre;
- Familjarizohen me platforma digjitale që mundësojnë përdorim dhe akses të pakufizuar dhe të shpejtë në informacionin mbi demokracinë vendore;
- Aftësohen në procedura online.

Fazat: Moduli bazohet në tre faza të zhvillimit personal:

- Faza 1: Eksplorimi - praktikuesit asimilojnë dhe zhvillojnë konceptet bazë të demokracisë digjitale.
- Faza 2: Adoptimi- praktikuesit zbatojnë praktikën e tyre digjitale dhe i zgjerojnë ato më tej.
- Faza 3: Drejtimi – praktikuesit përcjellin njohuritë e tyre, shprehen mbi praktikën ekzistuese.

Përshkrimi:

Pjesëmarrja digjitale ka rezultuar efektive në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies të sektorit publik, aty ku përdoret. Për një qeverisje të mirë dhe demokratike transparenca e organeve të qeverisjes vendore dhe informimi i publikut, konsiderohet një nga elementët thelbësorë që duhet të garantohen për të gjithë qytetarët.

Legjislacioni aktual shqiptar garanton të drejtën e informimit dhe transparencën në të gjitha nivelet e qeverisjes, përfshirë dhe atë vendor. Ndërkohë që situata duket e konsoliduar për sa i takon kuadrit ligjor në fuqi që garanton këtë të drejtë, akoma edhe më shumë angazhim dhe vullnet nevojitet nga institucionet publike për zbatimin e tij në praktikë dhe mundësimin e ndërgjegjësimin e qytetarëve për të përdorur mekanizmat e demokracisë digjitale në nivel vendor. Ligji Nr.119/2014 “Për të drejtën e Informimit”, i ndryshuar¹, Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr.116/2014, “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, synojnë të garantojnë në një nivel akoma më të lartë të drejtat kushtetuese dhe ligjore të individëve përkundrejt një administrate publike të hapur, transparente dhe në shërbim të tyre.

Në rrethin e organeve shtetërore për detyrim informimi janë edhe ato të qeverisjes vendore, ku theksi vihet në përdorimin e mekanizmave online dhe aftësimin e qytetarëve për përdorimin e platformave digjitale.

Mundësimi i aftësive digjitale të qytetarëve për të kuptuar dhe përdorur në mënyrë efektive instrumentet e demokracisë digjitale në nivel vendor, është një sfidë që duhet të adresohet nga ana e institucioneve vendore.

Pikërisht në këtë drejtim, aplikimi i mekanizmave efektivë në dispozicion të qytetarëve merr rëndësi, për të mundësuar nga njëra anë aksesin e tyre në këtë proces dhe nga ana tjetër për t'i dhënë mundësinë pushtetit vendor të njohë dhe kuptojë mendimin e qytetarëve, grupeve të ndryshme sociale, duke përmirësuar kështu vendimarrjen në interes të komunitetit, përmes mekanizmave të demokracisë digjitale.

✓ **E-demokracia dhe avantazhet e përdorimit të saj**

➤➤➤ E-Demokracia (demokracia elektronike/digjitale) përfshin përdorimin e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK) në mbështetje të proceseve demokratike me në qendër qytetarin.

Pjesëmarrja elektronike ose demokracia digjitale përkufizohet si përdorimi i mjeteve elektronike, kryesisht edhe pse jo vetëm nëpërmjet faqeve të internetit të qeverisjes vendore dhe internetit, për

¹ Ndryshuar me ligjin nr. 78/ 2023, datë 21.9.2023. Link:

<https://www.qbz.gov.al/eli/ligji/2014/09/18/119/994d10a1-a94c-47d6-afe3-736da383a167;q=119%2F2014,%20%20E2%80%98P%C3%ABr%20%20t%C3%ABdrejt%C3%ABn%20e%20informi mit%E2%80%99%E2%80%9D>

të promovuar dhe rritur angazhimin e qytetarëve dhe pjesëmarrjen në aktivitetet, programet dhe vendimmarrjen lokale.

Demokracia digjitale përfshin përdorimin *e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (TIK)* në mbështetje të proceseve demokratike me në qendër qytetarin. Kjo ndihmon në pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje dhe transparencën e veprimtarisë administrative.

Pushteti vendor duhet të krijojë mundësi që qytetarët të paraqesin ide dhe informacion, të renditin prioritetet, të ndajnë burime publike dhe të marrin njoftime për mbledhjet/debatet e ardhshme, si dhe platformat e angazhimit për përmirësime dhe buxhetim në nivel vendor. Veçanërisht këtu përmendim programin e transparencës, si detyrim që buron nga legjislacioni në fuqi për autoritetet publike vendore.

Proceset demokratike të përqendruara te qytetari konsiderohen ato që lejojnë angazhimin e qytetarëve në:

- marrëdhënie të vazhdueshme me përfaqësuesit e zgjedhur në nivel vendor,
- proceset përmes të cilave formohen politikat publike në nivel vendor,
- vendimet për ofrimin e shërbimeve dhe shpërndarjen e burimeve,
- një gamë të gjerë aktivitetesh të tjera joqeveritare dhe vullnetare.

Për më tepër, llojet e aktiviteteve që kemi parasysh kur flasim për demokracinë digjitale përfshijnë sa vijon:

- Përdorimi i teknologjive të votimit elektronik si shprehje e demokracisë pjesëmarrëse;
- Përdorimi i teknikave online për të treguar opinionin publik (si p.sh. nëpërmjet anketave dhe sondazheve në internet);
- Ndërtimi i komuniteteve online nga OJF-të dhe grupet e interesit në komunitetin lokal;
- Përdorimi i hapësirave të diskutimit në faqet online (website) për të stimuluar diskutimin dhe debatin publik online.

Në këtë mënyrë, demokracia digjitale është veçanërisht e rëndësishme për kontekstin aktual të qeverisjes vendore në të paktën dy aspekte të rëndësishme.

- E-Demokracia përfshin përdorimin e Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (TIK) në mbështetje të proceseve demokratike me në qendër qytetarin;
- Rëndësi në rastin e TIK merr interneti, i aksesueshëm nga një sërë pajisjesh që mundësojnë aksesin online në veprimtarinë e pushtetit vendor.

Teknologjia e informacionit dhe e komunikimit (TIK), luan sot një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në ndërveprimin mes autoritetit publik dhe qytetarëve. Nisur nga lehtësirat që ofron, TIK mund të përdoret:

- për të marrë informacionin e nevojshëm në kohë dhe me cilësi;
- për të rritur cilësinë e ofrimit të shërbimeve,
- për të përmirësuar efikasitetin e institucioneve publike,

- për të arritur një numër të madh njerëzish,
- për të promovuar transparencën dhe përgjegjshmërinë,
- për të lehtësuar ndërveprimin dhe pjesëmarrjen elektronike të qytetarëve në procese të ndryshme².

TIK-u luan një rol të rëndësishëm në lehtësimin e komunikimit dhe konsultimit, duke mundësuar një gamë të gjerë aktorësh të ndërveprojnë dhe të marrin pjesë në qeverisjen vendore dhe të kontribuojnë në vendimmarrje, drejtpërdrejt ose tërthorazi. Demokracia digjitale ofron mundësi të zgjeruara për një sërë aktorësh të ndryshëm që të përfshihen pothuajse në çdo aspekt të proceseve të diskutimit të politikave. Megjithatë, zhvillimet teknologjike janë të tilla që kërkojnë të ndiqet trendi teknologjik në ofrimin dhe përshtatjen e shërbimeve, p.sh. duke organizuar forume të diskutimit online, sondazhe online, vlerësime, votime online, etj., duke i dhënë mundësi qytetarëve të angazhohen për çështje me interes publik për komunitetin lokal³. Angazhimi përmes rrjeteve sociale mund të realizohet edhe në kombinim me metodat e tjera të konsultimit publik.

Prezantimi i platformave digjitale po përdoret edhe nga qeverisja vendore si pjesë e demokracisë digjitale dhe shërbimeve që ofrohen përmes saj. Nisur nga monitorimi i faqeve online të bashkive të vendit në fokus, shihet se në tërësi këto bashki ndajnë informacion në lidhje me planet dhe objektivat e tyre, operacionet e përditshme dhe ofrimin e shërbimeve (duke përfshirë mekanizmat për ndërveprim me pushtetin vendor).

Demokracia digjitale ofron mundësi të zgjeruara për një sërë aktorësh të ndryshëm që të përfshihen pothuajse në çdo aspekt të proceseve të diskutimit të politikave⁴.

• Platformat ekzistuese të e-demokracisë në nivel vendor

Ekzistojnë disa platforma online që sigurojnë informimin dhe pjesëmarrjen qytetare⁵ megjithatë, qytetarët janë pak të informuar dhe ndërgjegjësuar mbi këto instrumente të e-demokracisë çfarë ndikon negativisht në pjesëmarrjen dhe aktivizimin e tyre. Si platforma të tilla përmendim: e-Albania; vendime.al, Open data, Stop Korrupsioni, Pyesni Shtetin, Përmirëso Qytetin, aplikacioni celular Tirana Ime, platforma e komunikimit online me kryetarët e bashkive, platformat në mediat sociale etj.

Ne jemi fokusuar në përdorimin e mekanizmave të demokracisë digjitale në Bashkinë Kamëz, nga pikëpamja e mjeteve/mekanizmave të pjesëmarrjes elektronike të qytetarëve në nivel vendor, duke

²“E-government survey, digital government in the Decade of Action for Sustainable Development”, United Nations, New York, 2020.

³ “Manual udhëzues për njësitë e vetëqeverisjes vendore, angazhimi dhe konsultimi publik”, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Tiranë, Nëntor 2018, f.35.

⁴Digital democracy Is the future of civic engagement online?, European Parliament, 2020,

[https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2020/646161/EPRS_BRI\(2020\)646161_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2020/646161/EPRS_BRI(2020)646161_EN.pdf)

⁵Faqet web të bashkive, e-Albania, platforma vendime.al, Open data, Stop Korrupsioni, Pyesni Shtetin, Përmirësoni Qytetin tuaj, aplikacioni celular Tirana Ime, platforma e komunikimit online me kryetarët e bashkive, platformat në mediat sociale etj.

ndërlidhur kështu aspektin ligjor me respektimin në praktikë të zbatimit të mekanizmave të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK).

Kjo teknologji mundëson pjesëmarrjen dhe gjithëpërfshirjen e qytetarëve në proceset e vendimmarrjes me përdorimin e mjeteve të ndryshme të pjesëmarrjes elektronike⁶ (e-kontakt, e-forum, e-anketë, e-peticion, etj.).

Siç rezulton, **bashkia ka funksionale tashmë programin e transparencës** në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë qasje elektronike dhe forma të ndryshme të konsultimit digjital për qytetarët e saj.

➤➤➤ **Transparenca** është veprimtaria e hapur e një organi publik për të informuar në lidhje me aktet me interes të lartë publik, me proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse, që u siguron palëve të interesuara mundësinë për të marrë pjesë në këto procese.

Kjo synon rregullimin e marrëdhënieve që krijohen në një proces të konsultimit publik, transparent, gjithëpërfshirës, të realizuar në kohë dhe efektiv ndërmjet organeve publike qendrore dhe vendore dhe palëve të interesuara, në procesin e vendimmarrjes së projekt akteve si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politikave me interes të lartë publik.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë *koordinatorin e transparencës* dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.

Organet publike janë të detyruara të hartojnë dhe të publikojnë raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes, ku përfshihet informacion për:

- numrin e akteve të miratuara nga organi publik përkatës gjatë vitit referues;
- numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara;
- numrin e rekomandimeve e të komenteve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;
- numrin e takimeve publike të organizuara.

➤➤➤ **E drejta e informimit** – një e drejtë themelore me natyrë kushtetuese. Ajo implikon respektimin e të drejtës së informimit dhe realizimin e saj në praktikë, duke përcaktuar edhe detyrimet

⁶ “E-government survey, digital government in the Decade of Action for Sustainable Development”, United Nations, New York, 2020.

që burojnë nga ligji për organet publike në nivel qendror apo vendor, si dhe afatet e procedurat që duhet të respektohen në realizimin e kësaj të drejte.

E drejta e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike është një e drejtë bazë për qytetarin. Rregullat ligjore kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike, përfshirë edhe nivelin vendor.

- *Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.*
- *Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.*
- *Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.*
- *Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit.*

Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuesit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve. Kërkesat për informim regjistrohen sipas radhës së paraqitjes dhe trajtohen pa dallime mes tyre.

Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuesit:

- a) një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta;
- b) një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.

Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik. Në çdo rast, vendimi i refuzimit për formën e kërkuar jepet me shkrim dhe i arsyetuar.

➤➤➤ Konsultim publik është tërheqja e mendimeve dhe sugjerimeve të palëve të interesuara për përmbajtjen dhe përmirësimin e projektaktit, nga momenti i publikimit të projektaktit deri në miratimin përfundimtar të tij.

Për konsultimin publik janë të përcaktuara rregullat dhe procedurat e njoftimit e të konsultimit publik që zhvillohen nga organet publike në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse. Procesi i njoftimit dhe i konsultimit publik synon të garantojë:

- transparencë gjatë procesit të njoftimit e të konsultimit publik me pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe jodiskriminuese;
- efektshmërinë e procesit të vendimmarrjes në organet publike;
- përgjegjësinë e organeve publike ndaj palëve të interesuara.



Konsultimi publik në njësitë e vetëqeverisjes vendore

Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik.

• Mbledhjet e këshillit të bashkisë

Mbledhjet e këshillit të bashkisë janë të hapura për publikun. Çdo shtetas lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe në media të aksesueshme në njësinë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

Me kërkesën e kryetarit të bashkisë ose të një të pestës së anëtarëve të këshillit bashkiak, mbledhjet e këshillit bashkiak mund të bëhen të mbyllura, kur për këtë kanë votuar jo më pak se tre të pestat e gjithë anëtarëve të tij.

• Seancat e këshillimeve me bashkësinë

Këshilli bashkiak ose këshilli i qarkut, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë, të cilat janë të detyrueshme për disa raste.

Këshillimi me publikun, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme, si takimet e hapura me banorët e grupet e interesit, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata jofitimprurëse ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore. Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo bashki bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim.

• E drejta e kërkesës, ankesës dhe vërejtjes

Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetë-qeverisjes vendore. Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj.

• Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve

Autoriteti publik krijon, mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik. Identiteti i kërkuarve të informacionit nuk pasqyrohet në regjistër. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos standarde për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit⁷.

lidhja nr.1

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor ¹	Data e kërkesës ²	Objekti i kërkesës ³	Data e përgjigjes ⁴	Përgjigje ⁵	Mënyra e përfundimit të kërkesës ⁶	Tarifa ⁷

¹ Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

² Data e regjistrimit të kërkesës

³ Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁴ Data e kthimit të përgjigjes

⁵ Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

⁶ Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/ E refuzuar/E deleguar

⁷ Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

• Iniciativa qytetare

Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak. Propozimet e ardhura në këshill si iniciativë qytetare, kur kanë ndikim financiar në buxhetin e njësisë së vetëqeverisjes vendore, shqyrtohen në këshill, sipas rendit të ditës, dhe nuk mund të miratohen pa marrë më parë mendimin e kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

⁷https://www.idp.al/pt/Programi_i_transparences.html

✓ Përgatitja dhe miratimi i programeve të transparencës në bashkitë e vendit

Transparenca është një nga parimet më të rëndësishme të qeverisjes vendore dhe kontribuon në llogaridhënien e autoriteteve të qeverisjes vendore, si dhe në rritjen e besimit të komunitetit. Detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” u garantojnë qytetarëve akses në qeverisje dhe kushtet për të ushtruar të drejtat e tyre të njohura nga ligji. Autoriteti publik, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni⁸.

Në përgatitjen e projektprogramit të transparencës, mbahet parasysh interesi më i mirë i publikut dhe sidomos:

- a) garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
- b) vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- c) modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.

Në përputhje me programin e transparencës së miratuar dhe që zbatohet aktualisht, organet e njësisë të qeverisjes vendore, përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e përcaktuara të informacionit.

Përmes Modelit të Programit të Transparencës për Njësitë e Qeverisjes Vendore, Bashkia vendos në dispozicion të qytetarëve një kategori të gjerë informacioni, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre si dhe procedurat për t’i aksesuar dhe përdorur ato. Me anë të këtij informacioni, mundësohet njohja me organizimin dhe funksionimin e bashkisë, si dhe menaxhimin financiar; trajtimin e kërkesave për informacion, informacionin për procedurat që duhen ndjekur për të bërë një kërkesë për informim, adresën postare dhe elektronike për depozitimin e kërkesave për informim, si dhe procedurat e ankimit të vendimit përkatës; të dhëna për vendndodhjen e zyrave të autoritetit publik vendor, orarin e punës, emrin dhe kontaktet e koordinatorit për të drejtën e informimit; shërbimet publike që ofron bashkia përfshirë standardet për cilësinë e shërbimit; regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve, pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje, legjislacionin dhe aktet e brendshme rregullatore të miratuara, etj. Ky informacion duhet të jetë i aksesueshëm dhe i kuptueshëm nga individët dhe grupe të caktuara interesi, duke respektuar kufizimet ligjore për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.

Autoriteti publik, gjithashtu, krijon dhe arkivon një kopje digjitale të faqes zyrtare të tij në internet, të plotësuar me informacionin që kërkohet në programin e miratuar të transparencës, si dhe për

⁸ Raport monitorimi: “Transparenca proactive e 61 njësisë të vetëqeverisjes vendore”, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Tiranë, Nëntor, 2020.

metodat, mekanizmat dhe periodicitetin e publikimit të informacioneve publike, të cilat vihen në dispozicion të publikut pa kërkesë. Po ashtu, ai mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen e internetit të autoritetit publik, si dhe në mjediset e pritjes së publikut në zyrat e autoritetit publik, duke ruajtur anonimin dhe mosshfaqur identitetin e kërkuësve të informacionit në regjistër.

Programi i transparencës i publikuar nga bashkia (në faqet online zyrtare të tyre) duhet bazuar në parimin e:

- a) Vendosjes në dispozicion të çdo qytetari, të gjithë informacionit të prodhuar nga veprimtaria e bashkisë (nga organet e saj, administrata, njësitë administrative dhe njësitë e varësisë);*
- b) Ligjshmërisë, transparencës dhe të mos diskriminimit;*
- c) Ofrimit të informacionit pa pagesë. Informacioni i kërkuar në rrugë elektronike i jepet çdo qytetari pa pagesë;*
- d) Aksesit për këdo. Aksesit për shtresat më të varfra të komunitetit, qytetarët me aftësi të kufizuara, gratë, të rinjtë, biznesin, fermerët, qytetarët e zonave të largëta etj., merr përparësi;*
- e) Thjeshtëzimit të procedurave administrative për aksesin në informacion;*
- f) Dhënies së informacionit sa më shpejtë që të jetë e mundur.*
- g) Cilësisë së informacionit. Çdo informacion në dispozicion të qytetarëve do të jetë: – i plotë; – i saktë; – i përditësuar; – i thjeshtë në konsultim; – i kuptueshëm; – lehtësisht i aksesueshëm; – i pajtueshëm me dokumentet origjinale në administrim të bashkisë; – lehtësisht i përdorshëm.*

Për zbatimin e ligjit, me qëllim bashkërendimin e punës për garantimin e së drejtës së informimit, autoriteti publik vendor në këtë rast, cakton një prej nëpunësve si **koordinatori për të drejtën e informimit**.

Në lidhje me Programin e transparencës, çdo bashki ka mënyrën e vet të paraqitjes së zërave/rubrikave në këtë program. Po ashtu ndryshon edhe mënyra e organizimit të këtij programi nga një bashki në tjetrën⁹. Mungesa e një modeli standart e vërshtirëson gjetjen e informacionit për qytetarët që nuk mund të orientohen shumë mirë në website¹⁰.

Në bashki të ndryshme ka përvoja dhe eksperiencia të ndryshme, p.sh. modele suksesi në bashki të veçanta, që lidhen kryesisht me buxhetimin me pjesëmarrje, komisionet qytetare këshillimore, apo me diskutime në lidhje me planet vendore, por edhe këto modele nuk njihen dhe nuk janë promovuar sa duhet. Gjithsesi, sfidë mbetet jetëgjatësia e këtyre modeleve dhe konsolidimi dhe promovimi i tyre¹¹.

⁹ Raport monitorimi: “Vlerësimi i transparencës dhe llogaridhënies në nivelin e qeverisjes vendore”, IDM, Tiranë, 2021, f.16.

¹⁰ Raport monitorimi: “Vlerësimi i transparencës dhe llogaridhënies në nivelin e qeverisjes vendore”, IDM, Tiranë, 2021.

¹¹ “Manual udhëzues për njësitë e vetëqeverisjes vendore, angazhimi dhe konsultimi publik”, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Tiranë, f.6.




Regjistri elektronik për njoftimet dhe konsultimet publike

Çdo projekt akt publikohet në regjistrin elektronik për njoftimin dhe konsultimin publik. Ky regjistër është një faqe zyrtare interneti, e cila shërben si një pikë qendrore konsultimi, dhe nëpërmjet këtij regjistri sigurohet akses dhe ofrohet mundësia e komunikimit të të gjitha palëve të interesuara me organin publik. Kjo formë siguron dhe forcon barazinë për sa i përket aksesit në informacion dhe shërbim, duke pasur në vëmendje dhe nevoja specifike për persona apo grupime të caktuara.

Koordinatori i njoftimit dhe konsultimit publik

Çdo organ publik cakton një person si koordinator të njoftimit dhe konsultimit publik, i cili është përgjegjës për bashkërendimin dhe administrimin e përgjithshëm të punës për garantimin e së drejtës së njoftimit e të konsultimit publik, të parashikuar nga ligji.

<https://konsultimipublik.gov.al/> rubrika *Konsultime me qytetarët*



Pjesëmarrja elektronike konsiderohet se është me rëndësi, që do të sjellë më shumë interes për çështjet lokale krahasuar me mënyrat tradicionale për të marrë pjesë, pasi teknologjia e favorizon pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje. Pjesëmarrja në mënyrë elektronike është më e aksesueshme dhe secili mund të marrë pjesë pavarësisht vendit se ku mund të ndodhet, orës kur akseson informacionin etj, ndaj shihet si risi ndaj formave tradicionale.

Në mënyrë të përmbledhur, mund të konkludohet se përdorimi i platformave digjitale në nivel vendor:

-  Është më konveniente për qytetarin;
-  Promovon transparencën;
-  Rrit efikasitetin dhe efektivitetin;
-  Kursen kohë dhe automatizon detyra/funksione të caktuara;
-  Lehtëson aksesimin e të dhënave;

-  *Mundëson sigurinë kibernetike;*
-  *Eliminon distancat/largësinë gjeografike dhe mundëson komunikim në distancë;*
-  *Redukton shpenzimet;*
-  *Kontribuon në proceset e transformimeve digjitale dhe përhapjen e tyre;*
-  *Përmirësimi në cilësinë e shërbimeve të ofruara*

➤ **MODULI 2: Njohuritë bazë të nevojshme për përdorimin e internetit**

Kohëzgjatja: 1.5- 2 orë

Metodologjia: Metodologjia e përdorur në këtë modul do të jetë ajo e prezantimit të hapave të përdorimit të internetit dhe mënyrat e kërkimit të informacionit, të mësuarit e koncepteve të reja (ikonë, Google, motorr kërkimi, email etj.), si dhe ushtrimi praktik mbi mënyrën e përdorimit të internetit (metoda e kombinuar e mësimdhënies me pjesëmarrjen aktive të atyre që trajnohen). Paraqitja e materialit do të bëhet përmes prezantimit në ppt dhe paraqitjes vizive të ilustrimeve praktike të informacionit që trajtohen në këtë modul.

Objektivat: Ky trajnim synon mundësimin e aftësive bazë digjitale të qytetarëve për të kuptuar dhe përdorur internetin, për të aksesuar informacion, si dhe për të hapur një adresë emaili si një element i rëndësishëm në ditët e sotme për të aksesuar platforma dhe faqe të ndryshme interneti.

Grupi i synuar: Ky modul trajnimi është konceptuar kryesisht për individë që kanë nevojë për njohuri bazë në përdorimin e internetit dhe aksesin e platformave digjitale.

Rezultatet: Moduli do t'i ndihmojë pjesëmarrësit të:

- Njihen dhe aftësohen mbi mënyrën e përdorimit të internetit dhe koncepteve bazë të përdorimit të internetit;
- Njihen dhe përdorin motorrët e kërkimit, duke u ofruar përfituesve ndihmën dhe përvojën e duhur të aksesimit të tyre;
- Njihen dhe aftësohen mbi mënyrën e hapjes së një adrese e-maili.

Fazat: Moduli bazohet në tre faza të zhvillimit personal:

- Faza 1: Eksplorimi - praktikuesit asimilojnë dhe zhvillojnë konceptet bazë të përdorimit të internetit.
- Faza 2: Adoptimi – praktikuesit zbatojnë praktikatat e tyre të përdorimit të internetit dhe aksesit të informacionit në internet, si dhe i zgjerojnë ato më tej.
- Faza 3: Drejtimi – praktikuesit përcjellin njohuritë e tyre, diskutojnë dhe ndajnë eksperiencat e tyre.

Përshkrimi:

Teknologjitë digjitale kanë transformuar mënyrën se si jetojmë dhe punojmë. Ky transformim ka sjellë si nevojë të mësuarit dhe thellimin e njohurive të qytetarëve mbi mënyrën se si të përdorim teknologjinë dhe internetin në mënyrë të përshtatshme dhe efektive. Ky modul ka për qëllim aftësimin me njohuri praktike të qytetarëve mbi përdorimin bazë të internetit, për këtë qëllim, ky modul shoqërohet me përmbajtje praktike, si dhe demonstrim praktik i hapave që duhet të ndiqen.

Interneti është një rrjet global me miliarda kompjutera dhe pajisje të tjera elektronike. Me internetin, është e mundur të aksesosh pothuajse çdo informacion, të komunikosh me këdo tjetër

në botë dhe të bësh shumë më tepër. Sot, Interneti është një strukturë publike, bashkëpunuese dhe e vetë-qëndrueshme, e cila aksesohet nga qindra miliona njerëz në mbarë botën.

Në përgjithësi, interneti mund të përdoret **për të komunikuar** në distanca të mëdha ose të vogla, **për të shkëmbyer informacion** nga çdo vend në botë dhe **për të aksesuar informacione** ose përgjigje për pothuajse çdo pyetje në moment. Disa shembuj specifikë se si përdoret interneti përfshijnë: Media sociale dhe shkëmbimi i përmbajtjes; E-mail dhe forma të tjera të komunikimit, telefonja në internet, mesazhet e çastit, video-konferencat edukimin dhe vetë-përmirësimin përmes aksesit në programet e diplomave online.

Në përdorimin e internetit shpesh ndeshemi me koncepte të reja që mund të jenë të dëgjura për ju, si ikona, google, motorr kërkimi (search), e-mail etj. Por kujt i referohen këto terma dhe çfarë nënkuptojnë?

- **Çfarë është ikona?**


Një ikonë është një paraqitje grafike e diçkaje, një personi ose një simboli. Kur shfaqen në ekranet e kompjuterit, ikonat janë fotografi të vogla që përfaqësojnë objekte ose programe. Psh. Ikona e google, tek e cila klikojmë për të bërë kërkime të ndryshme, apo ikona e facebook/Instagram etj.

- **Çfarë është Google?**

Google është një motorr kërkimi në internet që mund të përdoret për të gjetur një sërë informacionesh, fotografishë, videosh, harta apo edhe vetëm përgjigje për pyetjen e adresuar etj.


Përfitimet dhe veçoritë kryesore të Google janë se:

- Ekziston një kuti e thjeshtë kërkimi në të cilën mund të shkruani pyetjen tuaj.
- Përgjigjet jepen pothuajse menjëherë. Ju mund të zgjidhni të kërkoni për faqe interneti, imazhe, lajme, harta dhe shumë më tepër. Ai do të bëjë sugjerime për terma alternativë kërkimi nëse shkruani gabim një fjalë ose emër.



- **Çfarë do të thotë motorr kërkimit? Si të bëjmë kërkime për të pasur akses në faqe të ndryshme?**

Një motor kërkimi është një shërbim që u mundëson përdoruesve të internetit të kërkojnë informacione të ndryshme në internet, përmes shkrimit prej tyre të një fjale kyçe apo një fraze të shkurtër. Nëpërmjet një fjale kyçe apo fraze kyçe që ju mund të shkruani në këto motorrë kërkimi, ju ofrohet një listë me rezultate të përmbajtjes që ju kërkuan në formën e faqeve të internetit, imazheve, videove ose të dhëna të tjera në internet që përputhen me pyetjen tuaj.




- **Si të hapin një adresë E-maili?**

Të paturit një adresë emaili është po aq i rëndësishëm në përdormimin e internetit dhe aksesimin e portaleve të ndryshme të demokracisë digjitale.

Qëllimi kryesor i e-mailit është shkëmbimi i mesazheve dhe informacioneve/domumentave në mënyrë elektronike nga një përdorues kompjuteri të një ose më shumë marrës nëpërmjet internetit. Përveç kësaj, të paturit një adresë emaili është kthyer në domosdoshmëri në aksesimin e faqeve të ndryshme të internetit apo aplikacioneve të ndryshme.


Në vijim ju ftoj të ndiqni mënyrën se si mund të hapni një email.

- ✓ Fillimisht klikojmë në ikonën e majtë të kompjuterit ku shfaqet një dritare e vogël me katër katrore.
- ✓ Shkruajmë Google me ndihmën e tastierës, dhe shtypim butonin Enter që ndodhet në të djathtë të tastierës suaj.




⇒ **Shpjegim:** Hapat që duhet të ndjekim për të hapur një adresë të re në gmail janë si më poshtë:

Hapim një dritare të re në Google (si në shpjegimin që bëmë më sipër), duke klikuar gmail.com në fushën përkatëse, pasi të na shfaqet dritarja më poshtë sipas shigjetës të treguar në foto klikojmë në butonin Enter nga tastiera në Create account.



Do të shfaqën tre opsione si në foton më poshtë, zgjidhni opsionin e parë *For myself*.



Pas këtij hapi do të shfaqet një dritare ku kërkohet të plotësoni disa të dhëna për të hapur një adresë si: Emër, Mbiemër; një adresë që dëshironi ju të krijoni *duhet të përfshijë numra, shkronja ose simbole, jo më pak se 8 karaktere. Më pas vendosni një kod (password) të sigurt që e rishkruajmë përsëri në kuadratin ku lexon Confirm dhe japim komandën Next.

Google

Create your Google Account
to continue to Gmail

First name Last name

Username @gmail.com
You can use letters, numbers & periods

Password Confirm
Use 8 or more characters with a mix of letters, numbers & symbols

☐ Show password

[Sign in instead](#) [Next](#)

One account. All of Google working for you.

Më pas do të shfaqet një dritare që kërkon nr. tuaj të telefonit në mënyrë që të merrni një kod me SMS, vendosni nr. tuaj të telefonit dhe do t'ju vij një kodi me SMS.

Google

Verify your phone number

For your security, Google wants to make sure it's really you. Google will send a text message with a 6-digit verification code.

Phone number

Standard rates apply

[Back](#) [Next](#)

Your personal info is private & safe

Hapi i radhës dhe i fundit është tabela e mëposhtëm, ku kërkohet nr. juaj i tel, adresa opsionale e emailit *nuk është e domosdoshme të plotësohet, vendosni muajin, ditën dhe vitin e lindjes si dhe gjininë, më pas shtypni butonin Next. Lexoni Politikat e Privatësisë dhe në fund klikoni “I Agree”. Ju tashmë keni një adresë email-i. * *Mbani mend kodin (password-in) ose shënojeni diku.*

Google

julia, welcome to Google

Phone number (optional)

Google will use this number only for account security. Your number won't be visible to others. You can choose later whether to use it for other purposes.

Recovery email address (optional)
We'll use it to keep your account secure

Month Day Year
Your birthday

Gender

[Why we ask for this information](#)

[Back](#) [Next](#)

Your personal info is private & safe

➤ **MODULI 3: Prezantimi i platformave ekzistuese dhe shpjegimi mbi mënyrën e përdorimit të tyre**

Kohëzgjatja: 1.5-2 orë

Metodologjia: Metodologjia e përdorur në këtë modul do të jetë ajo e prezantimit të platformave dhe mënyra e përdorimit të tyre nga qytetarët e kombinuar kjo me pjesëmarrjen aktive të trajnuarve (metoda e kombinuar e mësimdhënies me pjesëmarrjen aktive të atyre që trajnohen).

Paraqitja e materialit do të bëhet përmes prezantimit në ppt dhe paraqitjes vizive të ilustrimeve për zëra të ndryshëm që trajtohen në këtë modul, e shoqëruar gjithashtu me ushtrime praktike ku qytetarëve do t’ju kërkohej që njohuritë e marra nga prezantimi t’i zhvillojnë duke aksesuar drejtëpërdrejtë mekanizmat e demokracisë digjitale.

Objektivat: Ky trajnim synon mundësimin e aftësive digjitale të qytetarëve për të kuptuar dhe përdorur në mënyrë efektive platformat digjitale aktuale dhe mënyrën e aksesit në rubrika të ndryshme të këtyre platformave. Po ashtu, për bashkinë në fokus do të konkretizohen hapat që ndiqen për aksesin në këto platforma.

Grupi i synuar: Ky modul trajnimi është konceptuar kryesisht për individë që kanë nevojë për njohuri bazë në përdorimin dhe aksesin e platformave digjitale, si dhe ata që kanë nevojë për asistencë në përdorimin e mekanizmave të demokracisë digjitale. Por gjithashtu pjesëmarrja mund të përfshijë edhe ata që janë tashmë të familjarizuar me to dhe duan të kenë më shumë informacion mbi e-demokracinë.

Rezultatet: Moduli do t’i ndihmojë pjesëmarrësit të:

- Njihen me mënyrën e përdorimit të platformave digjitale dhe aksesin e informacionit të nevojshëm në to;
- Njihen dhe përdorin aplikacione digjitale, duke u ofruar përfituesve ndihmën dhe përvojën e duhur të aksesimit të tyre;
- Familjarizohen me platforma digjitale që mundësojnë përdorim dhe akses të pakufizuar dhe të shpejtë në informacionin mbi demokracinë vendore;
- Aftësohen në procedura online.

Fazat: Moduli bazohet në tre faza të zhvillimit personal:

- Faza 1: Eksplorimi - praktikuesit asimilojnë dhe zhvillojnë njohuritë e tyre mbi platformat ekzistuese të demokracisë digjitale.
- Faza 2: Adoptimi- praktikuesit zbatojnë praktikën e tyre digjitale dhe i zgjerojnë ato më tej në kuadër të përdorimit në mënyrë efektive të mekanizmave të demokracisë digjitale.
- Faza 3: Drejtimi – praktikuesit përcjellin njohuritë e tyre, shprehen mbi praktikën ekzistuese.

Përshkrimi:

Ekzistojnë një sërë platformash në shërbim të demokracisë digjitale të cilat lehtësojnë pjesëmarrjen qytetare në proceset vendimarrëse në nivel lokal, ndërmarrjen e peticioneve apo nismave elektronike, zhvillimin e diskutimeve, shprehjen e opinionit tuaj në mënyrë publike për çështjet lokale apo informimin me veprimtarinë e organeve vendore. Ky modul ka për qëllim të prezantojë dhe demostrojë përdorimin e platformave ekzistuese të demokracisë digjitale në nivel vendor në mënyrë që të nxisim përdorimin ato mënyrë efektive të tyre.

1. Faqet web të bashkive (rasti konkret: Bashkia Kamëz) , dhe mënyra e aksesimit të tyre

Ashtu siç u theksua edhe më sipër, për efekt të shtrirjes gjeografike të iniciativës “Të Rinjtë Për Vendimarrjen: Teknologji, Art dhe Pjesëmarrje!”, në fokus të këtij moduli do të jetë faqja web e Bashkisë Kamëz. Faqet zyrtare të bashkive kanë për qëllim të ofrojnë informacion për qytetarët lokalë mbi organizimin, veprimtarinë e njësive vendore, shërbimet publike që ata ofrojnë, aktet që nxjerrin organet e njësive të qeverisjes vendore, dokumentacionin e kërkuar për veprimtari të ndryshme, si dhe formate/formularë online për të lehtësuar shërbimet ndaj qytetarëve dhe ndërveprimin mes tyre.

Në faqet web të bashkive pasqyrohet si pjesë e detyrimit ligjor programi i transparencës (i trajtuar më sipër në këtë raport), koordinatori për të drejtën e informimit, modalitetet e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrje dhe iniciativa qytetare, konsultimi publik, si dhe në raste të caktuara platforma komunikimi me qytetarët.

Për aksesimin e faqeve web të bashkive do të ndiqen hapat siç u trajtua edhe në pjesën e dytë të këtij moduli mbi mënyrën e kërkimit në Google. Kështu, me ndihmën e tastierës në motorrin e kërkimit të google do të shkruajmë emrin e bashkisë të cilën po kërkojmë me fjalën kyçe, psh. Bashkia Kamëz ose <https://kamza.gov.al/>. Në rastin konkret, do të prezantohet mënyra e aksesimit të faqes web të Bashkisë Kamëz dhe rubrikat e saj.

➤ Bashkia Kamëz

Platforma zyrtare e Bashkia Kamëz përbën një pikë të rëndësishme hyrëse digjitale për nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe të rinjve në proceset e vendimarrjes lokale. Struktura dhe funksionalitetet e saj krijojnë disa hapësira të ndërlydhura, të cilat, nëse përdoren në mënyrë efektive, mund të forcojnë qeverisjen pjesëmarrëse në nivel vendor.



Për të aksesuar faqen web të bashkisë, do të shkruajmë në Google <https://kamza.gov.al/> dhe shtypim **Enter** në tastierën në mënyrë që të hapet faqja e kërkuar. Një dritare e re do të hapet, e cila na çon në faqen kryesore të Bashkisë së Kamëz. Në foton e demonstruar, paraqitet pamja aktuale që ka faqja e parë e web-it të Bashkisë Kamëz. Siç mund të shikohet, faqja web e Bashkisë Kamëz përmban disa rubrika si, “Bashkia”, “Këshilli Bashkiak”, “Shërbime” “Buxheti”, “Projekte”, “Transparenca” etj. Ju mund të klikoni në secilën nga rubrikat e paraqitura në mënyrë që të merrni informacionin që ku keni nevojë apo të konsultoni një document, vendim apo akt të publikuar nga Bashkia Kamëz.

Në thelb të platformës qëndron **kuadri i transparencës**, i cili mundëson aksesin publik në dokumente kyçe të bashkisë, si vendimet e Këshillit Bashkiak, informacionet buxhetore dhe planet strategjike. Kjo hapësirë luan një rol themelor në pjesëmarrje, pasi u ofron qytetarëve, veçanërisht të rinjve, mundësinë për të kuptuar mënyrën se si merren vendimet dhe si shpërndahen burimet publike. Në këtë kuptim, transparenca nuk është vetëm një detyrim institucional, por një parakusht për angazhim të informuar, duke i ndihmuar qytetarët të kalojnë nga marrës pasivë të informacionit në kontribues aktivë në diskutimin publik.

Një komponent tjetër i rëndësishëm është **hapësira e konsultimit publik dhe njoftimeve**, ku publikohen informacionet mbi dëgjesat publike, konsultimet dhe aktivitetet komunitare. Këto mekanizma krijojnë mundësi të drejtpërdrejta për qytetarët që të shprehin mendimet e tyre, të japin kontribut në hartimin e politikave lokale dhe të përfshihen në dialog me autoritetet vendore. Për të rinjtë, këto hapësira janë veçanërisht të vlefshme, pasi ofrojnë kanale të strukturuar për të artikuluar zërin e tyre dhe për të ndikuar në vendime që prekin drejtpërdrejt komunitetin. Megjithatë, efektiviteti i kësaj hapësire varet nga komunikimi në kohë, aksesueshmëria e informacionit dhe shkalla në të cilën kontributet e qytetarëve reflektohen realisht në vendimmarrje.


The screenshot displays the official website of the Municipality of Kamza. The top navigation bar includes links for 'Kreu', 'Bashkia', 'Këshilli', 'Shërbime', 'Buxheti i bashkisë', 'Projekte', 'Transparenca', and 'Informimi i publikut'. The main content area is divided into several sections:

- Njoftimet e fundit** (Latest News): Contains three news items with brief descriptions and links to full articles.
 - 1. Ndërmarrja e Ojëlberimit hap serë për kultivimin e luleve sezonale, në bashkëpunim me Shkolën Profesionale.
 - 2. Viojnë punimet për stadiumin e ri në Vllas, sipas standardeve të FIFA dhe IFAB, në bashkëpunim me FSHF.
 - 3. Shpallje Përgjegjës i Sektorit të Sekretariatit Teknik, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.
- Shërbimet** (Services): A grid of icons representing various services such as Information, Waste Management, Land Registry, and Public Works.
- Mesazh nga Kryetari** (Message from the Mayor): A featured article by Mayor Rakip Suli, discussing the municipality's vision and commitment to infrastructure and public services.
- Njoftimet e Kryetarit** (Mayor's Announcements): A section for specific announcements from the Mayor, including consultations and public meetings.

Platforma përfshin gjithashtu **shërbime online dhe mjete komunikimi**, si formularët e kontaktit dhe aplikimet për shërbime digjitale. Këto mjete u mundësojnë qytetarëve të paraqesin kërkesa, ankesa apo sugjerime drejtpërdrejt pranë administratës. Ky lloj ndërveprimi ul barrierat tradicionale të pjesëmarrjes, si distanca fizike apo kompleksiteti administrativ, duke e bërë angazhimin më gjithëpërfshirës dhe të arritshëm. Për të rinjtë, të cilët zakonisht kanë aftësi më të zhvilluara digjitale, këto mjete përfaqësojnë një hyrje të natyrshme drejt angazhimit qytetar.

Raporto një problem

Kategoria e problemit
 Zgjidhni kategorinë
 Lokacioni
 Vendlindja e problemit
 Përshkrimi i problemit
 Përshkruani problemin në detaje...
 Foto
 Choose File No file chosen
 Dërgo ankesën



Kontakt
 Bulevardi "Nënë Tereza", Kamëz
 +355 47 200 177
 info@kamza.gov.al

Bashkia kamëz
 Politikat e privatësisë

Nr e emergjencës
 Zjarrfikësja: 128
 Komisariati Nr. 5: 129, 200, 182
 Qendra Shëndetësore: 200, 237
 Spitali Usharak: 0694100077

© Bashkia Kamëz 2026. Të Gjitha Të Drejtat E Rezervuara

Një tjetër dimension i rëndësishëm është **rubrika e projekteve dhe iniciativave**, e cila ofron informacion mbi zhvillimet aktuale dhe të planifikuara në territor. Duke bërë publike investimet dhe projektet komunitare, platforma u jep mundësi qytetarëve të informohen, të monitorojnë zbatimin dhe potencialisht të përfshihen në iniciativat lokale. Kjo krijon hapësira jo vetëm për ndërgjegjësim, por edhe për mbikëqyrje qytetare dhe angazhim aktiv. Të rinjtë mund ta përdorin këtë informacion për të advokuar për prioritetet që lidhen me interesat e tyre, si arsimit, mjedisit apo hapësirat publike.

Këndi i BE
 koordinim.zhvillimi@kamza.gov.al

Misioni	Projekte këndi BE
Projekte	1 - Çerthëzimi i planit të zhvillimit të territorit 2 - Hapësirat e shërbimeve dhe ngritja e kapaciteteve të shërbimeve dhe të mirave me afërsi të kulluara, në bashkëpunim me bashkitë
Strategji	3 - Ngritja e shërbimeve të integruara shëndetësore dhe sociale për fëmijë me aftësi të kulluara. 4 - Ndërtimi i Qendrës së punës komunitare në vendlindje.
Këshilli Rinor	5 - Hapësira për programin e kërkimit
Aktivitetet	6 - Programi i kërkimit 1 (Të rinjtë e rinj) 7 - Programi i kërkimit 2 (Të rinjtë e rinj) 8 - Programi i kërkimit 3 (Të rinjtë e rinj) 9 - Programi i kërkimit 4 (Të rinjtë e rinj)
Migracioni dhe Diaspora	10 - Programi i kërkimit 5 (Të rinjtë e rinj)
Të tjera	11 - Programi i kërkimit 6 (Të rinjtë e rinj) 12 - Programi i kërkimit 7 (Të rinjtë e rinj) 13 - Programi i kërkimit 8 (Të rinjtë e rinj) 14 - Programi i kërkimit 9 (Të rinjtë e rinj) 15 - Programi i kërkimit 10 (Të rinjtë e rinj)

Dimensioni i **komunikimit publik dhe medias**, përmes lajmeve dhe lidhjeve me rrjetet sociale, e forcon më tej ndërveprimin mes bashkisë dhe qytetarëve. Këto kanale mundësojnë komunikim në kohë reale dhe zgjerim të audiencës, veçanërisht tek të rinjtë që janë më aktivë në platformat digjitale. Përmes komenteve, reagimeve dhe shpërndarjeve, ata mund të marrin pjesë në mënyrë informale, por me ndikim, në diskutimet publike dhe në ngritjen e çështjeve të komunitetit.

Së fundi, platforma ofron informacion mbi **strukturat vendimmarrëse**, përfshirë Këshillin Bashkiak dhe aktivitetin e tij. Kjo kontribuon në rritjen e kuptimit mbi proceset institucionale dhe

mënyrën e funksionimit të vendimmarrjes lokale. Duke i bërë këto struktura më të dukshme dhe të aksesueshme, platforma nxit llogaridhënien dhe mund të motivojë qytetarët të angazhohen më aktivisht, qoftë përmes monitorimit, advokimit apo pjesëmarrjes në mbledhje publike.

Në përfundim, platforma e Bashkisë Kamëz ofron një mjedis të shumëanshëm që mbështet përfshirjen e qytetarëve dhe të rinjve përmes transparencës, konsultimit, ndërveprimit digjital dhe aksesit në informacion institucional. Megjithatë, ndikimi i saj varet nga përdorimi aktiv nga qytetarët dhe nga gatishmëria e institucioneve për të reflektuar kontributet e marra në proceset vendimmarrëse. Forcimi i ndërveprimit, krijimi i mekanizmave të qartë të feedback-ut dhe zhvillimi i hapësirave të dedikuara për të rinjtë do ta rrisnin më tej rolin e saj si një mjet efektiv për qeverisje gjithëpërfshirëse në nivel lokal.


2. Portali e-albania¹²

Portali qeveritar shumëfunksional e-albania.al mundëson që çdo person i interesuar mund të marrë nëpërmjet internetit, shërbime elektronike të ofruara nga institucionet publike në Shqipëri. Ky portal është i lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit, e cila është arkitektura bazë mbi të cilën mundësohet ndërveprimi me sistemet elektronike të institucioneve publike.

E-Albania është një zyrë me një ndalesë për shërbimet online të administratës publike. Gjithashtu ky portal ofron informacion për qytetarin si dhe dokumentacionin e nevojshëm, procedurën që duhet të ndjekë, oraret e funksionimit dhe vendndodhjen e zyrave të administratës, kontaktet, si dhe adresën e faqes zyrtare të institucionit që ofron shërbimin përkatës, ku qytetari mund të orientohej për detaje të mëtejshme.

Po ashtu portali ofron mundësi komunikimi për çdo paqartësi, pyetje apo problem mbi regjistrimin, shërbimet e ofruara në portal, përmes forumit të portalit, postës elektronike, komenteve dhe mesazheve në rrjetet sociale¹³.

Kjo është një platformë online ku sot çdo qytetar apo biznes mund të logohen nga ID personale ose me Në këtë platformë ju merrni të gjithë shërbimet në telefonin apo kompjuterin tuaj personal.



¹²Linku për të aksesuar këtë portal: <https://e-albania.al/>

¹³<https://e-albania.al/Pages/eAlbania.aspx>


Përmes këtij portali, së fundmi qeveria aplikoi pyetsorin Këshillimi Kombëtar “Le të dëgjojmë njëri-tjetrin” me disa tematika kryesore, rezultatet e të cilit synojnë të përmirësojnë qeverisjen nga ana e institucioneve shqiptare, si dhe të adresohen problematikat kryesore që shqetësojnë shqiptarët.

3. Platforma Open Data Albania¹⁴

Open Data Albania është një platformë e cila ka për qëllim të mbledhë dhe të ruajë të dhëna mbi indikatorët ekonomik-shoqërorë në Shqipëri. Kjo platformë mbledh, përpunon dhe publikon në formate të ripërdorshme të dhëna nga disa zyra publike shqiptare. Të dhënat që ofrohen përmes kësaj platforme janë me rëndësi në lidhje me transparencën dhe kontrollin e aktiviteteve të ndryshme publike.

Kjo platformë është pjesë e programeve të transparencës të ndërmarra ndaj qeverive dhe zyrave publike në mjaft vende nëpërmjet publikimit të të dhënave “Open Data” në internet. Ashtu siç evidentohet nga informacioni në këtë platformë, në Shqipëri, megjithëse është e detyrueshme që të ofrohen të dhëna mbi aktivitetin e çdo zyre publike, në shumicën e rasteve ky detyrim nuk respektohet. Po ashtu, edhe në rastet kur të dhënat ofrohen, shpesh ato nuk janë të plota, jepen në formate të papërshtatshme apo dhe të papërdorshme në mënyrë informative.

Një tjetër problem i të dhënave të publikuara, për aq sa publikohen, lidhet me mirëmbajtjen dhe ruajtjen e këtyre të dhënave. Në disa raste ato hiqen nga faqet web për arsye të ndryshme.




4. Platforma QytetariIN¹⁵

Kjo platformë ka për qëllim të rrisë pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrjen e Këshillave të Bashkive Tiranë, Durrës dhe Kurbin duke fuqizuar qytetarët, organizatat dhe grupet e interesit për të luajtur një rol aktiv në përcaktimin e përparësive zhvillimore të komunitetit dhe territorit ku ata banojnë apo punojnë duke ndërmarrë peticione dhe iniciativa elektronike. Përmes kësaj platforme

¹⁴Linku për të aksesuar platformën Open Data Albania: <https://ndiqparate.al/?cat=668>

¹⁵Linku për të aksesuar këtë portal: <https://qytetariin.com>

synohet forcimi i *demokracisë vendore dhe inkurajimi i pjesëmarrjes aktive të qytetarëve, organizatave dhe grupeve të interesit në proceset politikëbërëse dhe vendimmarrëse të Bashkisë, si dhe në influencimin e axhendën qeverisëse të Bashkisë.*




5. Portali “PyetShtetin.al”¹⁶

Portali “PyetShtetin.al” është një iniciativë e përbashkët e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale dhe Fondacionit Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, Soros. Ky portal synon t’i vijë në ndihmë të gjithë qytetarëve për të gjetur me lehtësi informacione me karakter publik të hartuara nga të gjithë autoritetet publike në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Portali mundëson që çdo qytetar apo/dhe çdo grup interesi të mund të dërgojnë në mënyrë të thjeshtë elektronike kërkesat pranë Institucioneve shtetërore përgjegjëse si edhe mund të dërgojë ankesa në rast refuzimi të informacionit të kërkuar pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale. Ky sistem synon të lehtësojë aksesin e qytetarëve apo/dhe çdo grupi interesi për informacion publik si edhe të rrisë cilësinë e shërbimit duke ofruar mundësinë për të marrë informacionin publik në një kohë më të shkurtër. Nëpërmjet këtij sistemi mund të gjurmohet statusi i kërkesës nëpërmjet kanaleve informative. Ky sistem aktualisht është instaluar dhe po funksionon në 145 institucione.


¹⁶Linku për të aksesuar këtë portal: <https://regjistri.pyetshtetin.al/home>



6. Platforma Opendata.gov.al¹⁷

Ky është portali i të dhënave të hapura për Shqipërinë. Përmes këtij portali merren të dhëna, informacion dhe dokumenta në kuadër të nismës “Partneriteti për Qeverisjen e Hapur”.

Një rubrikë e veçantë në këtë portal i dedikohet konsultimit publik.



7. Platforma Përmirëso Qytetin¹⁸

Kjo platformë synon t’u vijnë në ndihmë qytetarëve për të përmirësuar cilësinë e jetës në lagjen dhe komunitetin ku jetojnë. Për të zgjidhur sa më shpejt problemet dhe për të afruar qytetarin me bashkinë është krijuar 'Përmirëso Qytetin'. Këtu qytetari mund të dërgojë ankesën në mënyrë elektronike direkt nëpërmjet kompjuterit apo celularit të tij dhe të marri përgjigje sa më shpejt për problemin.

¹⁷Linku për të aksesuar këtë portal: [Portali i të dhënave të hapura - OpenData https://opendata.gov.al](https://opendata.gov.al)

¹⁸Linku për të aksesuar: www.permiresoqytetin.al

The image shows three sequential screens of a mobile application titled 'Përmirëso Qytetin' (Improve the City).
 Screen 1: 'ZGJIDH QYTETIN' (Choose the City). It has a dropdown menu and a list of categories: 'Pastrimi i qytetit' (City Cleaning), 'Infrastruktura rugore' (Road Infrastructure), 'Institucionet' (Institutions), and 'Ndricimi' (Lighting).
 Screen 2: 'Zgjidh kategorinë e problematikes' (Choose the category of the problem). It includes a title field, a description field, an option to 'Bashkëngjit një foto të problematikes' (Attach a photo of the problem), and a 'Vazhdo!' (Continue) button.
 Screen 3: 'Përkujto sa më qartë problemin' (Remember the problem as clearly as possible). It includes a 'Përcakto në hartë vendndodhjen' (Locate on map) button, a 'Plotëso të dhënat personale' (Fill in personal data) section with fields for 'Emër dhe Mbiemër' (Name and Surname), 'Adresa Email' (Email Address), and 'Numër Telefoni' (Phone Number), and a 'DËRGO ANKESEN TENDE!' (SEND MY COMPLAINT!) button.

8. Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (konsultimipublik.gov.al)

Për efekt të qeverisjes transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për të pasur një komunikim më të hapur me qytetarët dhe shoqërinë civile, AKSHI ka implementuar Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në adresën konsultimipublik.gov.al. Ai do të shërbejë si një mundësi konsultimi mes qytetarëve dhe institucioneve vendimarrëse në Shqipëri. Kjo platformë është një mbështetje e rëndësishme teknike për të mundësuar komunikimin midis të gjitha institucioneve me qëllim automatizimin maksimal të procesit të njoftimit dhe konsultimit public. Ky regjistër elektronik tashmë është pjesë integrale e portalit e-albania, duke lehtësuar kështu aksesin dhe komunikimin me qytetarët.


The image is a screenshot of the 'Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike' (Electronic Register for Notifications and Public Consultations) website. At the top, there is a logo of two stylized figures and the title. Below the title is a search bar with the placeholder text 'Kërko' (Search). A navigation bar contains the word 'KONSULTIME' and a link to 'PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9154, DATË 6.11.2003*PËR ARKIVAT'. The main content area features four blue buttons: 'Konsultime me qytetarët' (Consultations with citizens), 'Konsultime me ekspertët' (Consultations with experts), 'Konsultime sipas institucioneve' (Consultations by institution) with a dropdown menu 'Zgjidh institucionin', and 'Sondazhe' (Surveys). At the bottom, there is a footer with links: 'Rreth nesh' (About us), 'Konsultime me qytetarët', 'Konsultime me ekspertët', 'Raporte', 'Raporte 2021', 'Institucione', 'e-Albania', and 'Kontakt'.

9. Platforma Kombëtare vendime.al¹⁹

Kjo platformë mundëson të publikohen online vendimet e 61 këshillave bashkiakë të Republikës së Shqipërisë. Platforma përfaqëson Arkivën Kombëtare të Akteve Legjislative të Pushtetit Vendor për të 61 bashkitë e vendit referuar ndarjes aktuale administrative-territoriale.

Përmes VENDIME.AL kushdo njihet shpejt, në çdo kohë dhe pa pagesë me vendimet e këshillit bashkiak. Publikimi i vendimeve dhe njoftimi i tyre efektiv është një detyrim ligjor që buron nga ligji i ri 139/2015 “Për Vetë-Qeverisjen Vendore” dhe ajo i shërben bashkive të Shqipërisë për të realizuar njoftimin e vendimmarrjes së tyre, si dhe i shërben të gjithë qytetarëve, subjekteve juridike dhe fizike nën juridiksionin e bashkisë, duke iu mundësuar atyre njohjen efektive të legjislacionit vendor. Përmes kompiuterit ose celularit vendimet e reja hapen ose shkarkohen në çdo kohë nga administratori ose stafi i NJA dhe mund t’i vihen në dispozicion cdo të interesuari, pa qenë nevoja të ndërmerret një udhëtim i posaçëm në qendrën urbane ku ndodhet bashkia.

Kjo platformë gjithashtu i shërben të gjithë aktorëve të tjerë të interesuar në nxitjen dhe promovimin e vendimmarrjes vendore përmes inovacionit dhe teknologjive TIK, të cilat ofrojnë shpejtësi në dhënie/shpërndarjen e informacionit, reduktim të kontaktit me zyrtarëve dhe publikut si dhe mbulim të gjerë.



¹⁹<https://www.vendime.al>

- **MODULI 4:** Siguria në përdorimin e internetit dhe platformave. Mbrojtja e të dhënave personale dhe shmangia e keqinformimit.

Kohëzgjatja: 1.5-2 orë

Metodologjia: Metodologjia e përdorur në këtë modul do të jetë ajo e prezantimit të koncepteve dhe parimeve që lidhen me mbrojtjen e të dhënave personale dhe atyre me natyrë sensitive, siguria e rrjetit, siguria në përdorimin e platformave online dhe mënyra e përdorimit të tyre nga qytetarët (metoda e kombinuar e mësimdhënies me pjesëmarrjen aktive të atyre që trajnohen).

Paraqitja e materialit do të bëhet përmes prezantimit në ppt dhe paraqitjes vizive të ilustrimeve për zëra të ndryshëm që trajtohen në këtë modul.

Objektivat: Ky trajnim synon ofrimin e njohurive të nevojshme dhe mekanizmave të mbrojtjes nga çdo formë keqpërdorimi me të dhënat personale dhe garancive të platformave në lidhje me të dhënat personale dhe sigurinë në internet.

Grupi i synuar: Ky modul trajnimi është konceptuar kryesisht për individë që kanë nevojë për njohuri bazë në përdorimin dhe aksesin e platformave digjitale, si dhe ata që kanë nevojë për asistencë në përdorimin e mekanizmave të demokracisë digjitale. Gjithashtu pjesëmarrja do të përfshijë edhe ata që janë tashmë të familjarizuar me to dhe duan të kenë më shumë informacion mbi e-demokracinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Rezultatet: Moduli do t'i ndihmojë pjesëmarrësit të:

- Njihen me mënyrën e përdorimit të platformave digjitale dhe aksesin e informacionit të nevojshëm në to duke mbrojtur të dhënat personale;
- Njihen dhe përdorin aplikacione digjitale, duke u ofruar përfituesve ndihmën dhe përvojën e duhur të aksesimit të tyre përmes mjeteve/masave të sigurisë në përdorimin e internetit;
- Mbrojnë të dhënat e tyre personale dhe parandalojnë keqpërdorimin e informacionit personal që shkëmbehet në internet.
- Njohja mbi shmangien e keqinformimit dhe aksesimin e informacioneve të besueshme.

Fazat: Moduli bazohet në tre faza të zhvillimit personal:

- Faza 1: Eksplorimi - praktikuesit asimilojnë dhe zhvillojnë njohuritë e tyre mbrojtjen e të dhënave personale dhe shmangien e keqinformimit.
- Faza 2: Adoptimi – praktikuesit zbatojnë praktikën e tyre digjitale dhe i zgjerojnë ato më tej në kuadër të mbrojtjes së të dhënave personale dhe keqinformimit.
- Faza 3: Drejtimi – praktikuesit përcjellin njohuritë e tyre, shprehen mbi praktikën e zhvilluar.

Përshkrimi:**Mbrojtja e të dhënave personale**

Në epokën digjitale, shtrohet gjithnjë e më tepër intensiteti i shkëmbimit të informacionit dhe aksesit në këtë informacion që mundësohet përmes TIK. Përdorimi i teknologjive të reja kërkon edhe adresimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë. Del e nevojshme rritja e ndërgjegjësimit për riskun në lidhje me përdorimin e platformave digjitale, për të mundësuar që njerëzit të kenë akses në mjedisin digjital me besueshmëri dhe të sigurtë, si dhe duke respektuar të drejtat e kujtdo.

➤➤➤ E dhënë personale quhet çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social

Shembuj të të dhënave personale janë: *Emri, Mbiemri; Adresa; Fotografia; Shenjat biometrike; Profesioni dhe Kualifikimet; Të ardhurat;* si dhe çdo e dhënë në lidhje me një person fizik e cila e bën të identifikueshëm drejtëpërdrejtë apo tërthorazi quhet e dhënë personale.

**Të dhënat sensitive**

Të dhënat sensitive janë një kategori e caktuar e të dhënave personale që përmban informacion më sensitiv për individin që ka të bëjë me origjinën e tij, racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësimin në sindikata, besimin, fetar apo filozofik, dënimin penal, si dhe të dhëna për shëndetin dhe jetën seksuale.

Ka mjaft rreziqe në përdorimin e internetit, disa janë më të rëndë, disa më të lehtë. Ka ndër këta viruse që fshijnë totalisht sistemin tuaj, disa të tjerë futen në sistemin tuaj dhe ndryshojnë skedarët, disa viruse të tjerë përdorin kompjuterin tuaj për të sulmuar kompjutera ose sisteme të tjera, disa vjedhin informacionin tuaj të kartës së kreditit për të bërë blerje të paautorizuara apo të dhëna të tjera sensitive, etj.

“Përpunim i të dhënave personale” është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.

Masat e sigurisë mund të minimizojnë mundësitë e një sulmi të mundshëm ndaj jush/pajisjes tuaj (kompjuter, celular, laptop etj). Ndaj duhen mbrojtur paisjet tuaja me programe të sigurisë – Firewalls – Antivirus – Antispyëare. Ndaj duhet të jeni të kujdesshëm dhe të “matur” kur përdorni Internetin.

Po ashtu, zyrat e IT (Teknologjisë së Informacionit) në bashki janë përgjegjëse për instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve kompjuterike në bashki. Ekipi i IT-së merret kryesisht me çështje të tilla si: zbatimi i protokolleve të sigurisë kibernetike, përditësimi i teknologjisë së vjetëruar, instalimi dhe mirëmbajtja e kompjuterëve, Ëi-Fi, administrimi dhe përditësimi i të dhënave, etj.

✓ *Mbrojtja e të dhënave personale në nivel bashkie*

Përpunimi i të dhënave personale plotësisht ose pjesërisht, bëhet nëpërmjet mjeteve automatike, dhe me mjete të tjera që mbahen në një sistem arkivimi apo kanë për qëllim të formojnë pjesë të sistemit të arkivimit pranë Bashkisë.

Çdo punonjës i strukturave të Bashkisë, që merret me përpunimin e të dhënave personale të subjekteve, detyrohet të zbatojë kërkesat e neneve 2 dhe 5 të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar: dhe mund t’i përdorë të dhënat personale vetëm për kryerjen e detyrave të parashikuara nga ligji dhe në përputhje me aktet ligjore e nënligjore që rregullojnë mënyrën e përpunimit të të dhënave personale. Në këtë drejtim punonjësit e bashkisë duhet të mbajnë parasysh sa më poshtë:

- Respektimin e parimit për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private;
- Kryerjen e përpunimit në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme;
- Grumbullimin e të dhënave personale për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe kryerjen e përpunimit të tyre në përputhje me këto qëllime;
- Të dhënat që do të përpunohen duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
- Të dhënat duhet të jenë të sakta nga ana faktike dhe, kur është e nevojshme, të bëhet përditësimi i kryerja e çdo veprimi për të siguruar që të dhënat e pasakta e të parregullta të fshihen apo të ndryshohen;
- Të dhënat duhet të mbahen në atë formë, që të lejojnë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër sesa është e nevojshme për qëllimin, për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.



Siguria ne internet

❖ **Përpunimi i të dhënave personale;**

Praktikisht çdo gjë që bëjmë në jetën tonë të përditshme kërkon ofrimin e të dhënave personale. Cfarë ndodh me këto të dhëna më tej? Në platformat e administratës shtetërore të dhënat tona janë të mbrojtura me ligj dhe bëhen vetëm me **qëllim grumbullimi**, por çfarë ndodh në platforma e faqe të tjera online?

❖ Njihuni me Cookies HTTP

Cookies HTTP, ose kukit e internetit, janë ndërtuar posaçërisht për shfletuesit e internetit të internetit për të gjurmuar, personalizuar dhe ruajtur informacione rreth sesionit të çdo përdoruesi. Ato krijohen për t'ju identifikuar kur vizitoni një *website* të ri dhe për të ruajtur informacionin dhe preferencat tuaja individuale.

Personalizim. Reklamimi i personalizuar është mënyra kryesore se si përdoren cookies për të personalizuar seancat tuaja. Ju mund të shikoni disa artikuj ose pjesë të një sajti, dhe kukitë i përdorin këto të dhëna për të ndihmuar në krijimin e reklamave të synuara që mund t'ju pëlqejnë.

Ndjekje. Faqet e blerjeve përdorin skedarë kuki (cookie) për të gjurmuar artikujt që përdoruesit i kanë parë më parë, duke i lejuar faqet e internetit të sugjerojnë mallra të tjera që mund t'u pëlqejnë dhe të mbajnë artikuj në karrocën e blerjeve ndërsa vazhdojnë të bëjnë blerje. Ndërsa këto janë kryesisht për përfitimin tuaj, zhvilluesit e uebit përfitojnë gjithashtu shumë nga ky konfigurim.

Kini kujdes se çfarë shpërndani në internet. Shkëmbimi i informacionit personal është i sigurt në internet, por ndarja e informacioneve **private** nuk është i sigurt në internet. *Mos harroni se qeveria dhe banka nuk do t'ju dërgojë kurrë email ose mesazhe për të kërkuar detaje private.

❖ Përdorni SSL!

SSL është një teknologji enkriptimi që përdoret për të hyrë në faqet e internetit. Nëse përdorni <https://> në vend të <http://> në fillim të adresës së internetit për të vizituar një faqe interneti, atëherë komunikimi mbrohet nga enkriptimi SSL për të parandaluar përgjimin. Kjo është shumë e rëndësishme nëse jeni duke përdorur Wi-Fi për t'u lidhur me internetin, pasi shumë pika të nxehta Wi-Fi nuk kanë aktivizuar enkriptimin e integruar.

❖ Si të mbronit të dhënat personale dhe privatësinë në internet?

Kini parasysh se interneti është një hapësirë publike dhe se të dhënat e postuara në internet janë të disponueshme për publikun.

- Privatësia në një mjedis online është po aq e rëndësishme sa është në botën reale - mos postoni në internet gjëra që nuk do t'i ndanit me një të huaj në rrugë.
- Ndani informacionin personal vetëm me njerëzit me të cilët jeni të afërt; mos e ndani me të huajt.
- Lexoni me kujdes Kushtet e Shërbimit dhe Politikën e Privatësisë përpara se të filloni të përdorni ndonjë platformë, aplikacion ose shërbim të internetit.
- Respektoni kufizimet e moshës për përdorimin e internetit, mbani në mend se i lini të dhënat tuaja personale në çdo faqe interneti që vizitoni.
- Mendoni në mënyrë kritike! Përpara se të postoni ndonjë informacion ose të dhëna personale në internet, mendoni për imazhin e vetes që u dërgoni të tjerëve dhe mënyrën se si e formoni identitetin tuaj dixhital.

- Mbroni privatësinë e fëmijës suaj. Mos shpërndani informacione personale (foto të një fëmije) në rrjetet sociale, sepse kjo ofron shumë mundësi për keqpërdorim nga njerëz keqdashës.
- Flisni me fëmijën tuaj për të dhënat personale, diskutoni rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë në internet, shpjegoni hapat konkretë që një fëmijë duhet të ndërmarrë nëse dikush kërkon informacionin e tij/saj personal.

❖ *Po viruset?*


Është e vështirë të jesh 100% të sigurt në internet, por ka hapa që mund të merrni për të mbajtur kompjuterin dhe celularin tuaj nga marrja e një virusi.

1. Instaloni softuer antivirus. Ju mund ta blini ose shkarkoni këtë.
2. Mos hapni email nga njerëz që nuk i njihni.
3. Mos hapni asnjë dokument (shtojcë) nga dikush në emailin tuaj nëse nuk e dini se çfarë është, pasi ekziston mundësia që të ketë një virus.
4. Mos shkarkoni (ruani gjërat nga faqet) që nuk i njihni ose i dyshoni.
5. Ju mund të merrni një virus në çdo pajisje që shkon në internet.

❖ *Si të kryej pagesa të sigurta në internet në rastet kur ju nevojitet që të merrni një dokument apo shërbim nga mekanizmat digjital?*

Është gjithashtu e rëndësishme të jeni të kujdesshëm nëse vendosni të përdorni internetin për të kryer pagesa të ndryshme. Vendosni të dhënat e kartës tuaj vetëm në faqet e internetit të sigurta. Shikoni për shenjat e mëposhtme për të ditur se po bëni pagesa të sigurta:

Simboli i drynit. Duhet të ketë një dry në shiritin e adresave pranë adresës së faqes së internetit.



Adresa e faqes se internetit duhet të fillojë me **https://**. "S" do të thotë i sigurt. Gjithmonë sigurohuni që **https://** të shfaqet në fillim të adresës së uebit përpara se të jepni ndonjë informacion

personal sensitiv (si p.sh. numrat e kartave të kreditit) nëpërmjet internetit në faqet e internetit të besuara.

Shiriti i gjelbër i adresave. Në disa shfletues dhe faqe interneti, shiriti i adresave do të bëhet i gjelbër.

Certifikatë e vlefshme. Nëse klikoni simbolin e drynit ose thjesht në të majtë të shiritit të adresave, duhet të shihni informacionin në certifikatën e sitit. Kjo duhet t'ju tregojë se kush e ka regjistruar sitin. Nëse merrni një paralajmërim për një certifikatë, shmangni faqen e internetit.

➤ **MODULI 5: Platforma e-demokracia**

Kohëzgjatja: 1.5-2 orë

Metodologjia: Metodologjia e përdorur në këtë modul do të jetë e orientuar më tepër në aspektin praktik, duke orientuar pjesëmarrësit në lidhje me njohjen dhe përdorimin e platformës së krijuar në mënyrë të posaçme për demokracinë digjitale dhe për mundësimin e aftësive digjitale të qytetarëve. Paraqitja e materialit do të bëhet përmes prezantimit në ppt dhe paraqitjes vizive të ilustrimeve për zëra të ndryshëm që trajtohen në këtë modul.

Objektivat: Ky trajnim synon mundësimin e aftësive digjitale të qytetarëve për tu njohur dhe për të përdorur platformën e-demokracia në mënyrë efektive, duke thelluar njohuritë e tyre online mbi konceptin e demokracisë digjitale, njohjen me mekanizmat e demokracisë digjitale dhe aftësimin në përdorimin e tyre, njohjen dhe aftësimin në përdorimin e internetit, ruajtjen e të dhënave personale etj.

Grupi i synuar: Ky modul trajnimi është konceptuar si për individë që kanë nevojë për njohuri bazë në përdorimin dhe aksesin e platformave digjitale dhe internetit, ashtu edhe për ata që janë tashmë të familjarizuar me to por kanë nevojë për asistim me qëllim përdorimin në mënyrë efektive të tyre.

Rezultatet: Moduli do t'i ndihmojë pjesëmarrësit të:

- Njihen me përmbajtjen e platformës dhe aplikacionit celular;
- Përdorin në mënyrë efektive platformën/aplikaconin celular.
- Familjarizohen me hapat e nevojshëm të aksesimit të mekanizmave të demokracisë digjitale.

Fazat: Moduli bazohet në tre faza të zhvillimit personal:

- Faza 1: Eksplorimi - praktikuesit asimilojnë dhe zhvillojnë njohuritë e tyre në përdorimin e platformës dhe aplikacionit celular e-demokracia.
- Faza 2: Adoptimi– praktikuesit zbatojnë praktikën e tyre digjitale dhe i zgjerojnë ato më tej nëpërmjet aplikacionit celular dhe platformës.
- Faza 3: Drejtimi – praktikuesit përcjellin njohuritë e tyre, shprehen mbi praktikën e zhvilluar.

Përshkrimi:

Platforma “e-demokracia” është një mekanizëm online (platformë dhe aplikacion celular), i cili ju mundëson të informoheni dhe të thelloni aftësitë digjitale në përdorimin e internetit dhe mekanizmave të demokracisë digjitale. Pjesë e kësaj platforme është, ndërt të tjera, informacioni i prezantuar në këtë modul të Paketës së Aftësisimit Digjital. Në këtë mënyrë, platforma dhe aplikacioni celular “e-demokracia” ofron:

- informacionin e paketës së aftësimit teknologjik bazë në forma të ndryshme në varësi të grupit të synuar;
- mbështetje individuale për qytetarët në rast nevojë lidhur me çështje të ndryshme të aksesit dhe përdorimit të platformave ekzistuese të e-demokracisë (forum i hapur diskutimi);
- informacion të përmbledhur dhe të kuptueshëm për qytetarin (eEnabeling) mbi e-demokracinë, kërcënimet ndaj privatësisë dhe mbrojtjes së të dhënave, keqinformimi etj.;
- një përdorim të thjeshtëzuar të mekanizmit nga çdo qytetar (nuk kërkon njohuri të thelluara teknologjike apo aparate celulare dhe kompjuter të teknologjive më të reja);
- lidhjen me mekanizmat ekzistues të e-demokracisë, në mënyrë që të mund të orientoheni lehtësisht në aksesimin e këtyre mekanizmave.

Informacioni i paketës së aftësimit digjital është pasqyruar **platformën online** me qëllim që të mund të aksesohet nga të gjithë qytetarët që kanë akses në internet, si dhe në një **aplikacion për celularë iOS dhe Android** i cili do të mund të aksesohet falas edhe offline për qytetarët që nuk kanë akses në internet. Aplikacioni celular përmban informacion si platforma online, si dhe garanton sigurinë e të dhënave të mbledhura. Mekanizmi është krijuar në formë të tillë që mund të jetë **i kopjueshëm** me qëllim aplikimin dhe përhapjen e tij në bashki të tjera.

Nëpërmjet e-demokracia “paketa e aftësimit digjital” shërben për t’i përcjellë qytetarëve nëpërmjet videove tutorial, njohuritë bazë të aksesit, kërkimit, përdorimit të internetit dhe të platformave ekzistuese të e-demokracisë të identifikuara, mbrojtjes së të dhënave personale, shmangien e keqinformimit/mashtrimit, asistimit në rast nevojë për identifikimin dhe përdorimin e mekanizmave të e-demokracisë etj.

- ❖ *Në mënyrë të detajuar dhe praktike do ju demonstrojmë të gjithë hapat e përdorimit dhe mundësitë që ju ofron kjo platformë dhe aplikacioni celular.*



➤ **MODULI 6: Ushtrime praktike për përdorimin e platformave**

Kohëzgjatja: 1.5-2 orë

Metodologjia: Metodologjia e përdorur në këtë modul do të jetë e orientuar më tepër në aspektin praktik, duke orientuar pjesëmarrësit në lidhje me një procedurë konsultimi publik. Paraqitja e materialit do të bëhet përmes prezantimit në ppt dhe paraqitjes vizive të ilustrimeve për zëra të ndryshëm që trajtohen në këtë modul.

Objektivat: Ky trajnim synon mundësimin e aftësive digjitale të qytetarëve për të kuptuar dhe përdorur në mënyrë efektive instrumentet e demokracisë digjitale në nivel vendor, duke praktikuar njohuritë e fituara me qëllim familjarizimin me mekanizmat e e-demokracisë.

Grupi i synuar: Ky modul trajnimi është konceptuar si për individë që kanë nevojë për njohuri bazë në përdorimin dhe aksesin e platformave digjitale, ashtu edhe për ata që janë tashmë të familjarizuar me to.

Rezultatet: Moduli do t'i ndihmojë pjesëmarrësit të:

- Njihen me procedurat e konsultimit publik;
- Përdorin njohuritë e përfutuara mbi demokracinë digjitale, duke u ofruar përfituesve përvojën e duhur të aksesimit të tyre;
- Familjarizohen me procedura të caktuara konsultimi publik.

Përshkrimi:

Siç u përmend më sipër, konsultimi publik është një element i rëndësishëm i demokracisë vendore. Për efekt të këtij moduli, do të ndalemi në disa aspekte praktike se si mund të përfshihen qytetarët në një proces konsultimi publik, duke mundësuar kështu pjesëmarrjen direkte dhe aktive nga ana e tyre.

Në fund të vitit, Këshilli i Bashkisë harton dhe bën publik Raportin Vjetor për Transparencën dhe Konsultimin Publik të procesit të vendimmarrjes ku përfshihet informacioni në lidhje me:

- ✓ numrin e akteve vjetore të miratuara nga Këshilli i Bashkisë;
- ✓ numrin e akteve të përmirësuara si rezultat i procesit të konsultimit;
- ✓ numrin e takimeve publike të planifikuara dhe të organizuara;
- ✓ numrin e pjesëmarrësve në konsultimet publike dhe përkatësia gjinore;
- ✓ numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të dhëna nga palët e interesuara për projekt-aktet e konsultura publikisht;
- ✓ numrin e rekomandimeve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të vendimmarrjes;

Raporti vjetor mbi konsultimin publik duhet të përgatitet dhe publikohet brenda muajit Mars të vitit pasardhës. Konsultimi publik jep mundësi që njerëzit të zgjedhin vetë se ku dhe në çfarë mase duan të jenë të angazhuar për çështje komunitare. Angazhimi mund të bëhet edhe përmes metodave të kombinuara të konsultimit publik (online dhe fizike).

Së pari, është zgjedhur një Model i procedurave të miratimit të një akti bashkiak që kalon në konsultim publik²⁰.

Bashkia do të kalojë në konsultim publik një akt:

- Ideja e hedhur nga Departamentet e saj (ose nga grupe interesi) që mbështetet në Planin e Përgjithshëm Vendor apo në strategjinë për zhvillim ekonomik për Bashkinë:
Baza ligjore: Ligji Nr. 139/2015, Neni 18; Ligji Nr.107/2014; Ligji 146/2014
- Përgatitet materiali për konsultim që duhet të jetë i thjeshtë dhe i kuptueshëm.
- Përgatiten prezantimet me ppt ose edhe animime apo Video sipas rëndësisë.
- Bëhen njoftimet përmes:
 - Faqes së internetit të Bashkisë;
 - Media Lokale;
 - Grupe interesi.
- Në këtë fazë merren mendime nga qytetarët apo grupet e interesit të cilët ndihmojnë bashkinë për të rritur impaktin e ndërhyrjes apo shpenzimeve publike.
- Mendimet e qytetarëve pas konsultimit trajtohen në bashki duke u konsultuar me grupin e hartimit të strategjisë apo në departamentet përkatëse dhe dilet me një Projekt Vendim.
Koha: Jo me pak se 2 muaj para mbledhjes së Këshillit Bashkiak
- Projekt vendimi shkon në Këshillin Bashkiak.
 - a. Sekretari i këshillit e delegon në komisionin përkatës.
 - b. Komisioni përkatës autorizon sekretarin e Këshillit që të organizojë takimet e Këshillit Bashkiak për konsultimin Publik sipas territorit; sipas grupeve të interesit;
Koha: Një muaj para mbledhjes së Këshillit Bashkiak
- Konsultim me publikun nga Këshilli Bashkiak
 - a. Bëhet njoftimi përmes:
 - Media lokale;
 - Ndërlidhësit komunitar apo Kryetarët e fshatrave si dhe struktura të tjera komunitare sipas tipit të projekt vendimit;
 - Faqes së internetit të Bashkisë;
 - Rrjete sociale.

²⁰“Manual udhëzues për njësitë e vetëqeverisjes vendore, angazhimi dhe konsultimi publik”, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, Tiranë, f.45-46.

- b. Nqs është një projekt vendim shume i rëndësishëm tërhiqet mendim edhe me anë të aplikacioneve (IT) ose në faqe web ku për variantet e paraqitura qytetarët shprehin qëndrimet e tyre.
- Mendimet e qytetarëve pas konsultimit publik të projekt-vendimit i kalohen Kryetarit të Bashkisë dhe Kryesisë së Këshillit.
 - Komisioni përkatës harton Raportin për Projekt-Vendimin dhe ia kalon Sekretarit të Këshillit të Bashkisë.
Koha: Dy deri në tre javë para mbledhjes së Këshillit
 - Kryesia e këshillit pasi ka miratuar rendin e ditës së mbledhjes së këshillit, autorizon sekretarin e këshillit që të përgatisë materialet, ndër të tjera Projekt Vendimin e konsultuar së bashku me relacionet përkatëse (gjatë kësaj kohe, ka hapësirë për reflektim në lidhje me sugjerimet apo reagimet e komunitetit)
Koha: 10 ditë para mbledhjes së Këshillit Bashkiak
 - Projekt Vendimi kalon në Këshill Bashkiak për diskutim dhe miratim.
Koha: Jo më vonë se 5 ditë para mbledhjes së Këshillit
 - Vendimi i Këshillit Bashkiak Shpallet.
Koha: Menjëherë pas miratimit nga Prefekti.